

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Raporti sekret për Ramiz Alinë në vitin 1990: Rite fetare e kryqe në Himarë e Dhërmi, turistët dyshohen s i agjentë grekë!                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/dossier/raporti-sekret-per-ramiz-aline-ne-vitin-1990-rite-fet-are-e-kryqe-ne-hima-i587187">https://www.gazetatema.net/dossier/raporti-sekret-per-ramiz-aline-ne-vitin-1990-rite-fet-are-e-kryqe-ne-hima-i587187</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 20 shtator 2026, 07:09:39 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 07:30:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 03d93c255ea7791ff8fb662299377654a89b689903acae73762e394bac4d079a |
| TEKSTI     | c7db8f98681f3617c9c9172792e79714d233049ef52f7d4c75d15e50d277c845 |
| PAMJA      | 17007ece4bba89b1f275bfe94c0e7d3b500a03b966380e06ff076308f9157a9  |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | a7630b57269cc4dff6073d51bfaf55b753d70fb8fffb68e003ae416056528f45                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a7630b57269cc4dff6073d51bfaf55b753d70fb8fffb68e003ae416056528f45>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)

English

le [Irani ekzekuton nje person te denuar per spiunazh, akuzohej se i dha Mossadit te dhena per bazat rakitore](#) [Komandanti amerikan: Mbi nje miliard fuqi natte u transport](#)  
fundit

## Raporti sekret për Ramiz Alinë në vitin 1990: Rite fetare e kryqe në Himarë e Dhërmi, turistët dyshohen si agjentë grekë!



20 Shtator 2026, 09:30 Dossier TEMA



### Nga Dashnor Kaloçi

Kur nuk kishte kaluar as një javë nga data 2 korrik e vitit 1990, ku me mijëra shtetas shqiptarë kapërcyen kangjellat e muret e ambasadave të huaja në Tiranë dhe u futën brenda ambienteve të tyre me qëllim për t'u larguar nga Shqipëria, udhëheqja e lartë e PPSH-së me në krye sekretarin e Përgjithshëm Ramiz Alia, mbajti plenumin e 11-të të Komitetit Qendror, i cili zhvilloi punimet në datat 6 dhe 7 korrik. Edhe pse rendi i ditës ishte paracaktuar në tre pika kryesore, ku predominonte ajo për zhvillimin e arsimit në Shqipëri, pothuaj gjatë gjithë punimeve të atij plenumi (sidomos te pika 4, "Të ndryshme"), u diskutua dhe u debatua ngjarja e atyre ditëve, e njohur ndryshe si "2 korriku i ambasadave". Në atë plenum ku merrnin pjesë të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror të PPSH-së, sekretarët e parë të komiteteve të partisë të rretheve, ministra, kuadro kryesorë të sektorit të arsimit, kulturës, shkencës, ekonomisë, drejtues të organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës së Shqipërisë, nga aparati i Komitetit Qendror të PPSH-së, Radio-Televizioni, ATSH-ja etj., mungonin Nimet Cani, Ali Vukatana, Reiz Malile, Shpëtim Çausi, Zylyftar Ramizi, Qemal Lame, Zef Loka, Pirro Kondi dhe Hekuran Isai, të cilët prej disa ditësh ishin "në terren", duke "menaxhuar", ngjarjen e ambasadave.

Pas hapjes së mbledhjes nga Ramiz Alia, fjala iu dha ministrit të Arsimit, Skënder Gjinushit, i cili mbajti dhe raportin përkatës, ("Për përsosjen e sistemit arsimor dhe forcimin e mëtejshëm cilësor të shkollës"), kryefjala e atij plenumi ishte "ngjarja e ambasadave", duke diskutuar dhe analizuar me detaje se si dhe pse ndodhi ajo, ("roli i agjenturave të huaja"), e deri tek detyrat që dilnin për menaxhimin e asaj situatë në ato ditë të nxehta korriku, ku mbi pesë mijë shtetas shqiptarë nga të gjithë rrethet e vendit, ndodheshin në ambientet e brendshme të disa prej ambasadave kryesore në Tiranë, në pritje të largimit nga Shqipëria.

Përveç kësaj, gjatë gjithë asaj mbledhje, por kryesisht në pikën nr. 4 të rendit të ditës, (që u diskutua në seancën e fundit), u morën në analizë edhe disa prej ngjarjeve kryesore që kishin ndodhur në rrethe të ndryshme të vendit gjatë atij viti, si; protestat në Shkodër në muajin janar për heqjen e bustit të Stalinit; ngjarjet në qytetin e Kavajës ku populli i atij qyteti u përlesh me forcat e policisë; arratisjet masive nga kufijtë shtetërorë me Jugosllavinë e Greqinë, grumbullimet masive në vende të shenjta fetare, si Kisha e Shën-Ndout në Laç të Kurbinit; tejimi me ligj i besimeve fetare dhe hapja e objekteve të kultit; apo probleme të tjera që shtriheshin për zgjidhje, si; bisedimet e faktorin ndërkombëtar për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-ën, Bashkimin Sovjetik, (bisedimet e zhvilluar me zv. ministrin e Jashtëm sovjetik në Sofie nga Sofokli Lazri); problemi i Kosovës; presioni ndërkombëtar për hapjen e Shqipërisë me botën dhe aderimi i saj në disa konventa ndërkombëtare; privilegjet e udhëheqjes së lartë të PPSH-së e familjeve të tyre që jetonin kryesisht në "Bllok"; fjalët që qarkullonin në popull për familjen e Enver Hoxhës dhe raportet e Ramizit me Nexhmijen; ndryshimi i legjislacionit dhe kodit penal; lirimi i të burgosurve politikë; pisja me pasaporta e shtetasve që kërkonin të dilnin si vizitorë tek të afërmit e tyre jashtë vendit; mekanizmi i ri ekonomik; strehimi dhe

zema me punë e shumë shtesave në të gjitha rrethet e vendit, dënimi e tokës dhe pagëtuve ishataresive kooperativiste, e dën të furnizimit i popullsisë së qyteteve me produktet bazike ushqimore e mallrave të ndryshme industriale.

Siç do të shohim dhe nga dokument arkivore që i përkasin plenumit të 11-të të Komitetit Qendror të PPSH-së, të cilat theksojmë se publikohen për herë të parë, përveç udhëheqjes dhe disa prej funksionarëve të lartë të asaj kohe, në atë mbledhje kanë diskutuar apo janë përmendur edhe disa figura të tjera të larta që vazhduan karrierën e tyre politike edhe pas viteve '90-të, si p.sh.; Skënder Gjinushi, Fatos Nano, Sali Berisha, Rexhep Mejdani, Gramoz Pashko, Spiro Dede, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Moikom Zeqo, Mehmet Elezi, Lisen Bashkurti, Koço Kokëdhima, Ylli Popa, Aleks Luarasi etj.

Po kështu në dosjen voluminoze të këtij plenumi, me mjaft interes janë edhe ato dokumente që i përkasin sekretarëve të Komiteteve të Partisë së rretheve apo "Grupit të informacionit" të cilët kanë shkruar në të gjitha rrethet e vendit dhe kanë evidentuar të gjitha problematikat kryesore që kanë dalë në mbledhjet e organizatave bazë të partisë, ku është diskutuar "Mbi letrën e Komitetit Qendror", dokumente që përbëjnë dhe pjesën më të madhe dhe gjithashtu më të rëndësishme të dosjes në fjalë. Madje mund të thuhet nga më të rëndësishmet të gjithë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës dhe pasardhësit të tij Ramiz Alia, pasi ajo periudhë kohe me ngjarjet që u zhvilluan, shënoi dhe prologun e rënies së atij regjimi.

Po kështu me mjaft interes janë dhe dokumentet që i përkasin seancës së fundit të asaj mbledhje me pikën nr. 4 të rendit të ditës "Të ndryshme", e cila përbën edhe pikën më të nxehtë të gjithë plenumit, ku u diskutua, madje me debate të ashpra, edhe lirimi nga detyrat dhe nxjerrjen në pension të tre anëtarëve të Byrosë Politike (Rita Marko, Manush Myftiu dhe Prokop Murra), apo lirimi nga detyrat ministrore apo funksionet e tjera të larta që mbanin prej vitesh të disa "udhëheqësve" të tjerë, si Simon Stefani, Pali Miska, Muho Asllani, Lenka Çuko, Vito Kapo, Pirro Kondi, Jovan Bardhi, etj., dhe emërimin e "shokëve të rinj" në udhëheqjen e forumet e larta të Partisë dhe Shtetit, si; Xhelil Gjoni, Abdyl Backa, Niko Gjyzari, Kiço Mustaqi, etj. Lidhur me këto etj., na njohin dokumente në fjalë të nxjerra nga Arkivi Qendror i Shtetit (Fondi i ish-Komitetit Qendror të PPSH-së), të cilat publikohen për herë të parë dhe me faksimilet përkatëse nga Memorie.al.

## **RAPORT-INFORMACIONI I SEKRETARIT TË PARË TË KOMITETIT TË PARTISË SË RRETHIT TË VLORËS, HALIL HASKO, DËRGUAR SEKRETARIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH-SË RAMIZ ALIA**

### **KONKLUZIONE E DETYRA QË DALIN NGA DISKUTIMI I LETRËS SË KQ TË PARTISË.**

Në të gjitha organizatat bazë të Partisë dhe në popull u diskutua për problemet e mëdha që shtrihen letrë e Komitetit Qendror të Partisë. Secili ka nxjerrë mësimet e veta. Sot, në Plenumin e Komitetit të Partisë të rrethit do të diskutojmë së bashku mbi konkluzionet që kemi arritur dhe detyrat që na dalin për të ardhmen. Procesi i demokratizimit të jetës politike, ekonomike e shoqërore të vendit i shprehur në vendimet e Plenumëve të kohëve të fundit të Komitetit Qendror të Partisë është i pakthyesëm.

Situata e re komplekse e brendshme dhe e jashtme, gjithë Partinë e ka vënë para detyrash e zgjedhjesh të reja. Si t'i kuptojmë e si të vihem në krye të këtyre situatave që iniciativën, në çdo moment ta kemi në dorë ne komunistët, kjo është një nga pyetjet dhe detyrat më të vështira, ky është çelësi i suksesit të punës së Partisë. Ky është objekti i Plenumit të sotëm.

Problematika e gjerë e plenumëve të KQ të Partisë, të rejat dhe zhvillimet që ato sjellin, nuk ishin e nuk janë të lehta për t'u kuptuar. Kuptimin e tyre e vështirësoi edhe vazhdimi me metoda e vjetra në punën e Partisë. Lëvizshmërisë së situatave nuk i vumë përballë atë dinamizëm e atë zhdërvjelltësi që kërkohej. Situatat e reja nuk përballohen me frazeologji e me slogane, por me argumente bindëse, shpjegime të kohës. Mungesa e kuptimit, mëdyshjet e deri te lëkundjet se mos këto ndryshime kanë të bëjnë me ndryshime në vijë sollën një tërheqje e një defensivë në punën e Partisë.

U gjallëruan elementët armiq, të cilët fillimisht nxorën në ballë kontingjente të gënjerish e me nivel të ulët, sidomos nga radhët e punëtorëve të rinj. Në momentin e përshtatshëm ata dolën dhe vet me parulla të hapura armiqësore, duke nxjerrë realitetin dhe përparimet tona, duke nxitur e ngjallur urrejtje për Partinë pushtetin popullor, për komunistët, udhëheqjen e Partisë e idealet socialiste e pati prej tyre që thoshin: "Erdhi koha jonë".

Gjatë diskutimit të Letrës së Komitetit Qendror të Partisë, komunistët pranuan se ne nuk ishim përgatitur për të përballuar situata të tilla. Tolerancës që sollën ndryshimet demokratike e aq më tepër shtyrjes e in-disiplinimit që domin të shkaktonin armiqë të me synim marrjen e pushtetit nuk iu përgjigjëm me punë sulmuese e të organizuar Partie. Në vend të këtyre lindi çoroditja, tula tja e deri mosbesimi në të ardhmen.

Kritika e asaj që nuk kemi bërë mirë është njëkohësisht edhe mësimi kryesor që nxjerrim për punën e Partisë. Të zotërojmë vazhdimisht situatat e të vihem në krye të tyre, sado e "zbutur" e ashpër apo e mprehtë të jetë lufta e klasave. Të mos lëshojmë pozicione. Lëshimi, tërheqja, indiferentizmi janë avantazhe e pozita të fituara nga armiku.

Përgatitjes politike e ideologjike të komunistëve e kuadrove në këto momente i shërbyen aktivet e Partisë që zhvilluan në të gjithë rrethin. Në të morën përgjigje mjaft pyetje e probleme që kishin dalë në popull, që shoku Ramiz Alia i trajtoi në takimin me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve në muajin korrik. Letra e Komitetit Qendror të Partisë ishte një përgjithësim i ri i problemeve e i shqetësimeve para të cilave ndodhën Partia e populli në momentet e sotme.

Ndërkohë që qarkullonin lloj-lloj shpifjesh, parullash, thashethemesh denigruese e armiqësore Letra konfirmoi edhe një herë qëndrimin zyrtar të Partisë për konsekuencën në vijën dhe rrugën që kemi zgjedhur vet për ndërtimin e socializmit. Krahas sqarimit të shumë çështjeve ideologjike, politike, ekonomike e të politikës së jashtme ajo ishte edhe një thirrje për gatishmëri e vigjilencë për mbrojtjen e pushtetit popullor, Partisë, socializmit e Atdheut.

Letra forcoi më tej bindjet politike dhe besimin te komunistët e masat për vijën e Partisë dhe drejtësinë e vendimeve të Plenumëve të Komitetit Qendror të Partisë. Organizatat e Partisë kritikuan naivitetin, plogëshinë, mungesën e orientimit e të mprehtësisë ideologjike, duke u përfshirë në vorbullën e shpifjeve e thashethemeve. Gjatë diskutimit të Letrës doli se pyetjet dhe paqartësitë janë të ndryshme e të shumëllojshme por kanë edhe anë të përbashkëta, dyshimet se mos kemi ndryshime në vijë. Njëri krah është ai konservator, që e atakon Partinë nga e majta.

Këta janë njerëz që ju dhimbset çështja, ju dhimbset Partia, por nuk janë të qartë e duhen sqaruar për përmbajtjen e synimet e ndryshimeve që bëjmë. Krahu tjetër është krahu liberal që e atakon Partinë nga e djathta. Ai çështjet që na të thyejnë në dy. Në anën e parë çështja e të zhvillimit të shpejtë ai krah tarat e

qetë e ashtu kanë operuar që e dalorin rruget nga e qajta. Ai përpiqet që ne të rrijmë qetë, ne e dimë se mbrëmjen e të zhvillimit të shpejt dhe me lehtë e privatizimit të ekonomisë, të kredisë skllavëruese pa kushte, të pluralizmit të Partisë etj.

Ose në mos dal hapur përmes presionit që bën për ndryshimin e menjëhershëm të kushteve të jetesës, jashtë mundësive tona monetare e materiale do që Partia të thyhet e të devijojë nga rruget e sovranitetit e lirisë dhe e pavarësisë. Njohja e prirjeve dhe e tendencave të tilla ndihmon në përcaktimin e drejtimeve të punës së organizatave bazë të Partisë në të ardhmen. Një pjesë e gjërave i sqaroi Letra e Komitetit Qendror të Partisë, të tjera t'i sqarojmë në punë e sipër.

Letra e Komitetit Qendror të Partisë i shërben forcimit të mëtejshëm të unitetit moralo-politik të popullit rreth Partisë. Entuziazmi dhe niveli me të cilin u festua 70-vjetori i Luftës së Vlorës, 47-vjetori i Luftës së Drashovicës dhe asaj të Çetës së Myzeqesë ishin manifestime dhe shprehje e gjallë e unitetit të popullit me Partinë e palëkundësisë dhe e mbështetjes vëllazërore që populli i bëri Partisë për ta udhëhequr në rrugën e zgjedhur për ndërtimin e socializmit.

Atmosferën revolucionare që krijoi Letra e Komitetit Qendror të Partisë e ngriti më tej ndjenjat atdhetare që populli i rrethit tonë shprehu në qindra letra e telegrame drejtuar KQ të Partisë dhe shokut Ramiz Alia, për pretendimet territoriale greke ndaj vendit tonë, ku ai shprehu zemërimin dhe indinjatën e thellë ndaj këtyre qëndrimeve provokuese e shoviniste.

Letra e Komitetit Qendror të Partisë i dha tone të reja qëndrimit ndaj punës e pronës shoqërore. Kudo janë pakësuar mungesat pa arsye. Në uzinën e Sodë-PVC ka një rritje të prodhimit ditor, nga 80 në 90 ton në ditë. Në mjaft brigada traktoriste janë marrë me realizimin e planit vjetor qysh më 29 Nëntor. Në fabrikën e çimentos po përgatiten që remontin e furrës ta bëjnë dy herë më shpejt se sa koha e planifikuar, e barabartë kjo me 4000-5000 ton çimento.

Në fabrikën e tullave u vendos të vihet në jetë një studim i bërë më parë për shtimin dyfish të rendimentit. Brenda këtij muaji do të fillojnë nga puna 50 njësi shërbimi të artizanatit dhe 28 të tregtisë me llogari më vete, si dhe do të hapen 10 njësi të reja të shërbimit artizanal.

Në të gjitha kooperativat bujqësore janë vendosur afate dhe po ndiqet zbatimi i masave suplementare për kompensimi e deficiteve të krijuara nga thatësira, për arritjen e vlerës së ditës së punës etj. Ngritja e ndërgjegjes politike të komunistëve e masave përbën një bazë të re për t'i qar punët më përpara. Para detyrash të tjera më të mëdha ndodhemi në të ardhmen.

Të forcojmë qëndrimin luftarak të organizatave bazë të Partisë, të komunistëve e kuadrove e punonjësve, punën politike me njerëzit ta vemë në plan të parë.

Të gjithë jemi të një mendimi se ne nuk ishim përgatitur për të përballuar situata të tilla, si ato që kaluam e po kalojmë. Lindi pyetja pse nuk ishim të përgatitur? Procesin e demokratizimit të jetës së Partisë e të masave, si mbledhjet e hapura të Partisë apo pluralizmi e mendimeve, disa komunist e interpretuan si likuidim apo shkrirje të rolit udhëheqës të Partisë, si fshirje kufijsh midis organizatës e komunistëve dhe pjesës tjetër pa Parti.

Për pasojë pati luhatje e lëshim të pozitave të Partisë. Ndërkohë që punët e Partisë u shtuan, komunistë e kuadro të paqartë e të mjegulluar në mendime u tërhoqën. Në vend që të shtonin forcat e të hidheshin në sulm, nuk punuan as ashtu siç kishim punuar më parë. Ndërkohë që më shumë se kurrë kërkohej vigjilencë, militantizëm, shpjegime të zgjuara e plot argumente, komunist e organizata Partie u hutuan, u krijua kështu një boshllëk i madh në punën e Partisë.

Pluralizmi i mendimeve krijon terren ballafaqimi e vështirësi më të mëdha. Ndeshja e të kundërtave dhe fitorja e asaj që është e partishme e në të mirën e popullit sot çan, me logjikën e forcën e argumentit. Komunistët e kuadrot tanë as për këtë nuk ishin të përgatitur si duhet. Komunisti është udhëheqës i masave. Por të ruash pozitën udhëheqëse në shoqëri duhet të bindësh me shembull, por dhe të rrëmbesh zemrat e njerëzve, me forcën bindëse të teorisë e të praktikës revolucionare.

"Monopoli" i ideve shumë gjëra i ka realizuar si me komandë e pa shumë mundime. Për pasojë disa komunistë kanë mbetur të plogët e të paafatë, ka prej tyre që koha i ka lënë mbrapa apo të tjerë që nuk u orientuan dot në ndryshimet e vullshme të brendshme e të jashtme. Ngjarjet e Lindjes disa i frikësuan dhe humbën besimin në të ardhmen.

Pra cili është konkluzioni? Për rrethanat politike të jashtme më të favorshme për të, armiku mori kurajo dhe është bërë më agresiv, por shkalla e demonstrimit të agresivitetit të tij varet nga ne. Po të jemi në sulm e në vigjilencë të pandërprerë armiku do struket e do tulatet, se pushtetin e kemi në dorë ne, populli, komunistët. Si e në ç'mënyrë mund të vihem në pozitë aktive e të sulmit, ç'duhet të bëjmë?

Së pari: ne komunistët e kuadrot aty ku punojmë e aty ku jetojmë të bëjmë jetën e militantit. Për militantin nuk ka qetësi, për atë indiferentizmi është i huaj, puls i rreh gjithmonë për çështjen e Partisë e të popullit. Ai s'mund të ndodhet asnjëherë larg njerëzve e nuk mund të luaj rolin e të "paditurit" siç ndodh në disa raste ku edhe pse gjërat bisedohen, madje tirren e organizohen, marrin përpjesëtime dhe komunistë e kuadro përfshi edhe sekretarë, drejtorë e kryetarë habiten se si u organizua një gjë e tillë, hiqen mënjatë si të pafuqishëm për rregullimin e gjendjes.

Militanti dëgjon e mëson se ç'mendon populli e çfarë shqetësime e pre-okupacione ka, si është situata politike, gjithnjë ai është i informuar e i azhurnuar. Në Himarë komunistë e kuadro thonë: "Habitemi si na u krijua kjo situatë"? Pse të habiten? Në qoftë se shikohet televizioni grek dhe njerëz të caktuar, me qëllim apo pa qëllim të keq, komentojnë ato që dëgjojnë, po kuadrot dhe shokët e tjerë të Partisë ç'bëjnë pse nuk shpjegojnë domethënien ose të kundërtat e tyre, pse nuk argumentojnë?

Në qoftë se të rinjve iu është prishur mendja nga turistët e vizitorët që vijnë tek ne, pse nuk interesohen, ç'njerëz përfaqësojnë këta? Janë njerëz dashamirës e realist apo janë korba të rinj e të dërguarit e asfalisë greke. E po qe nevoja të këshillojnë që ose të rrinë mirë ose të ikin paq andej nga kanë ardhur. Bëhen rite fetare në Dhërmë e në Himarë vendosen kryqe, organizohen tërë ata njerëz. Disa thonë pse të mos e shpërndajmë fondin e akumulimit, q'e duan.

Një pjesë e të rinjve kanë braktisur punën dhe bëjnë propagandë edhe të tjerëve. Aty është dhe shefi i planit të kooperativës, dhe nuk jep asnjë shpjegim. Pse? Kujt i shërbejnë qëndrime të tilla indiferente, veç shkallëzimit të kooperativës dhe rendit tonë politik! Ç'thotë ky "hermeticitet" i komunistëve e kuadrove, madje i përzier me frikë? Pushteti mbahet me luftë e qëndrime militante, frika dhe tërheqja na çojnë në humbjen e tij!

Militanti ose njeriu luftarak është i tillë se ka bindje të patundura në idealin e tij, në rrugën që kemi zgjedhur për ndërtimin e socializmit. Ai, burim frymëzimi ka

ideatet komuniste dhe Partine e tij. Në këtë aspekt është e parashikime që mjaft komunist në vend që vendimet e Përmirësime të Komitetit Qendror të përdorin si argumente sulmuese, kanë në prehrin e propagandës armiqësore.

Thashethemeve se; “nuk ka unitet në udhëheqje”, militanti u qëndron, kërkon kush e tha e si e argumenton ai që e tha. Lloj-lloj parullash: “Ju komunistët nuk dini gjë, do vijë koha të marrin tokat siç i kemi pasur para formimit të kooperativës “Pse të punojmë në kooperative”, “do bëhet pluralizëm partish”, tani ju komunistët mbaruat, i keni ditët të shkuara, boll na shtypët, erdhi koha jonë”, “Mjekësia do bëhet me para” etj. etj.

Po t’i shikosh me vëmendje ato kanë një prirje, një theks, një dëshirë, minimin e socializmit, të Partisë dhe të pushtetit popullor. Për ndodhitë e Himarës përgjegjësi të veçantë ka shoku Dhimitër Çali, si anëtar i Byrosë së Rrethit dhe drejtues i kooperativës.

Nuk mjafton vetëm pozimi i ndonjë situatë. Kryesorja është qëndrimi militant, lufta për shëndoshjen e gjendjes së sëmurë. Problemet e Himarës janë si rezultat i një pune të dobët Partie që bënë përgjegjëse org. bazë Partisë, komunistët dhe drejtuesit e organizatave shoqërore. Për armikun e brendshëm e të jashtëm, për “Zërin e Amerikës” Bi-bi-sinë e qarqe të tjera reaksionare, kjo është dëshira e madhe, për këtë u qan zemra dhe do të përpiqeshin me të gjitha forcat që të pabërën ta bëjnë të bërë. Kjo është ëndrra e tyre.

Po komunisti, kuadri e njeriu ynë, si nuk revoltohet, si nuk ngrihet ndaj këtyre njerëzve, gjuhë nepërka t’i denoncojnë, t’i demaskojnë, t’u tregojnë vendin. Atyre që janë të paqartë t’i sqarojnë, ndërsa të tjerëve që thonë erdhi “koha jonë”, t’u thonë: “Pa na jepni shpjegime për cilën kohë ëndërroni e cila kohë paska ardhur!? dhe ashtu “fshatçe” siç thekson artikulli “Zëri i Popullit”, dt. 14.9.1990, t’u bëjnë gjyqin në kolektiv se na prekin në gjënë më të shtrenjtë, më të dashur, në pushtetin popullor që e fituam me gjakun e 28 mijëve nga 70 mijë që u rreshtuan në rreshtat partizane. / Memorie.al

**P/BYRONË E KOMITETIT PARTISË RRETHIT**

**SEKRETARI I PARË I KOMITETIT PARTISË RRETHIT**

**Halil Hasko**

**Vlorë, më 20.9.1990**

**Lini një Përgjigje**

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.